

Përshkrimi i shkurtër i Projektit

PEE Kitka, një investim nga Kompania Air Energy SH.P K., është park energjetik me erë (impiant me erë) me vendndodhje në Kosovë, funksionon që nga tetori i vitit 2018. Impianti ka një kapacitet total të instaluar prej 32.4 MW dhe është impianti i parë me erë në vend. Air Energy është përgjegjës për mirëmbajtjen dhe funksionimin e impiantit. Impianti gjendet në Komunën e Kamenicës, në Kosovën Lindore, e cila është afërsisht 28 km në verilindje të qytetit të Gjilanit dhe 42 km në lindje të Prishtinës në Kosovën lindore. Zona e impiantit përbëhet nga nëntë turbina me erë, secila me 3.6 MW dhe furnizon rrjetin me energjinë elektrike që prodhon. Turbinat janë instaluar në një zonë barishtore malore dhe janë të vendosura larg zonave pyjore.

Strategjia aktuale e Kosovës për Energjinë vendos një objektiv ambicioz për prezantimin e rreth 400 MW të projekteve të burimeve të ripërtëritshme deri në vitin 2026. Kapaciteti i energjisë së ripërtëritshme para PEE Kitka ishte rreth 70 MW, pothuajse ekskluzivisht nga hidrocentralet e vogla. Duke qenë impianti i parë me erë në Kosovë, Projekti paraqet një moment historik drejt dekarbonizimit në Kosovë, ku mungesa e qasjes së besueshme në energji elektrike mbetet një nga barrierat më të mëdha për zhvillim. Më shumë energji e ripërtëritshme do të ndihmojë në adresimin e sfidës së ndërprerjeve të energjisë dhe ndotjes së shkaktuar nga thëngjilli i linjitet që furnizon dy impiantet kryesore të Kosovës. Projekti ka kontribuar në zbutjen e klimës duke rritur pjesën e gjenerimit të energjisë së ripërtëritshme në Kosovë dhe duke shtuar 32.4 MW kapacitet gjenerues të erës në sistemin kombëtar të energjisë si dhe duke mbështetur tranzicionin "e gjelbër" duke kontribuar në reduktimin e emetimeve të CO² në vend.